



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 33

Prishtinë, më 23.7.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Nezir Çoçaj, Arbërie Nagavci, Driton Çaushti, Abdyl Salihu dhe Albulena Balaj – Halimaj.

Munguan: Fidan Rekaliu, Valentina Bunjaku – Rexhepi, Verica Çeraniq, dhe Mufera Shinik.

Përfaqësues të tjerë: Vjollca Krasniqi, Xhavit Rexhaj, Rozafa Koliqi Lila, Dukagjin Zek-anëtarë të KSHC-së, Fisnik Gashi e Shkëlzen Gërxhaliu, zyrtar në AKA dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim i Komisionit me anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të AKA-së;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Takim i Komisionit me anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të AKA-së

Ismajl Kurteshi, falënderoi të pranishmit për përgjigjen pozitive të anëtarëve të Këshillit në ftesën e Komisionit për diskutimin e punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, për problemet dhe planet e punës.

Vjollca Krasniqi, tha se Agjencia e Akreditimit është autoritet i pavarur, i cili akrediton dhe riakrediton institucionet publike dhe private të arsimit të lartë për një periudhë të caktuar kohore. Kjo Agjenci është themeluar nga MASHT-i me udhëzim administrativ numër 11/2004, më 16 shkurt, 2004, si një mekanizëm që garanton cilësinë e punës arsimore dhe kërkimore, shkencore në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, i cili për herë të parë ka filluar me procesin e akreditimit në vitin 2009. Krasniqi, tha, se i gjithë procesi i akreditimit është kryer dhe vazhdon të kryhet nga ekspertë ndërkombëtarë, duke garantuar programe më cilësore për qytetarët e Kosovës.

Xhavit Rexhaj, tha se Këshilli Shtetëror i Cilësisë si anëtarë të ENKA-s, garanton dhe zbaton standardet më të larta që aplikohen në Evropë në procesin e akreditimit dhe riakreditimit. Ai tha se gjatë vitit të kaluar, ka ndodhur përjashtimi i Këshillit nga EQAR-ja , mirëpo, që ka filluar procesi i ripranimit si rezultat i punës së të gjitha subjekteve, Parlamentit, komisionit, ministrisë dhe Këshillit Shtetërorë të Cilësisë.

Rexhaj, tha së është krijuar një cilësi të re të komunikimit me mekanizma ndërkombëtarë dhe që në raport me BE-në, ka nisur procesi i hartimit të Ligjit për Agjencinë dhe miratimi i standardeve dhe udhëzuesit për akreditim, i cili konfirmon gatishmërinë e këshillit për të punuar sipas standardeve evropiane. Sa i përket aspektit ndërkombëtar, ai tha se, në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, janë mbajtur me dhjetëra takime me përfaqësues të ENKA-s, EQAR-it, ambasada të ndryshme, partnerët zhvillimorë në Kosovë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Sfidat e këtij këshilli, Rexhaj i cilësoi si sfida objektive, ku u përmenden: mungesa e personelit të mjaftueshëm në agjenci, mungesa e një drejtori me orar të plotë, mungesa relative e kushteve të punës për këshillin, numri i madh i kërkesave nga palët, si rezultat i ndërprerjes së funksionimit, mungesa e komisionit për ankesa.

Vjollca Krasniqi, tha se ndërtimi i besimit të punës së këshillit është një nga prioritetet kryesore të këtij këshilli, i cili bazuar në punën katër mujore, dalëngadalë ka filluar të krijohet. Ajo tha se ka nisur një vlerësim i lehtë nga partnerët ndërkombëtarë, me qëllim të rikthimit të Agjencisë së Akreditimit si anëtare e plotë e EQAR-it. Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, mbajti katër mbledhje, të cilat në numër mund të duken pak, mirëpo, që për një mbledhje këshilli është takuar deri në tre herë dhe dhjetëra takime në të cilat janë trajtuar kërkesat e institucioneve të arsimit të lartë.

Sa i përket aktiviteteve specifike, ajo përmendi vendimin për zgjatje të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit të institucioneve të arsimit të lartë, në mënyrë që të adresohet koha e humbur në mungesë të Këshillit Shtetërorë të Cilësisë dhe bazuar në nenin 13, pika 3 e Ligjit për Arsimin e lartë të Republikës së Kosovës, këshilli ka vendosur të shtyjë afatin e akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve për një periudhë njëvjeçare.

Në mënyrë që të mos mbingarkohet puna e këshillit, me rastin e fillimit të procesit të ri të akreditimit, mori vendim për zgjatjen e akreditimit për periudhën njëvjeçare për të gjitha programet e studimit, për universitetet publike dhe ato private. Ajo përmendi si masë tjetër edhe iniciimin e hartimit për pjesëmarrje në punën e grupit të punës për hartimin e Ligjit të Agjencisë së Akreditimit, grupi punues është themeluar më shumë se një muaj, rishikimin dhe aprovimin e standardeve të udhëzuesve të rinj për akreditim standardet do ta ndihmojnë këshillin në rrugën e tij për të siguruar cilësinë dhe integritetin akademik, përmes akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.

Ajo tha se është duke u bërë edhe verifikimi i stafit akademik nga ana e këshillit dhe shikimi i statusit të programeve të pezulluara, verifikimi i gjendjes së stafit akademik për të gjitha programet studimore të arsimit të lartë, sipas fushave të studimit, verifikimi i statusit të 3000 mësimitdhënësve të arsimit të lartë, sigurimi i transparencës në punën e agjencisë ndërmjet shoqërive civile dhe mediave, duke zbatuar plotësisht udhëzimin administrativ për akreditim.

Xhavit Rexhaj, tha se do këshilli do ta vlerësonte shumë përkrahjen e komisionit, me frymën e marrëveshjes që është bërë në prill të vitit 2018, të vazhdojë hartimin e Ligjit për Agjencinë e Akreditimit, emërimi i një drejtori të kualifikuar dhe kompetent si dhe plotësimi i stafit të agjencisë.

Teuta Haxhiu, falënderoi anëtarët e këshillit për praninë e tyre dhe raportimin. Ajo tha se ende ka nevojë për një raport përfundimtar rreth arsyeve të shkarkimit të komisionit paraprak. Për shkak të transparencës, ajo kërkoi nga këshilli që për takimet e tyre të njoftojnë komisionin si dhe informata mbi programet të cilat aktualisht kanë plotësuar kushtet e akreditimit. Në anën tjetër ajo kërkoi sqarime se pse disa fakultete kanë staf të mjaftueshëm dhe kërkesa është e madhe nga studentët, mirëpo, nuk akreditohen duke vazhduar me kërkesën e saj për sqarimin se si është vazhduar akreditimi i programeve edhe për një periudhë njëvjeçare, pa analizuar situatën e këtyre institucioneve.

Arbërie Nagavci, tha se ministri i MASHT-it është dashur të sjell një raport lidhur me Agjencinë e Akreditimit. Sa i përket rianëtarësimit të Agjencisë në EQAR, kërkoi sqarim lidhur me procedurat që duhet ndjekur dhe veprimet e ministrit që duhet ndërmarrë lidhur me këtë. Sa i përket akreditimit të disa programeve në fakultete të caktuara, Nagavci kërkoi sqarim lidhur me caktimin e prioritetëve për akreditim nga Agjencia si dhe lidhur me rastet e konfliktet e interesit.

Nezir Çoçaj, tha se përkushtimi im ka qenë që në Agjenci të jenë personat me kompetencë të dëshmuar akademike dhe profesionale. Ai kërkoi sqarim lidhur me veprimet e ndërmarra nga Agjencia për përmirësimin e situatës në arsim dhe cilat janë vlerësimet e ndërkombëtarëve për AKA.

Driton Çausi, foli për shqetësimet lidhur me mungesën e stafit akademik që u paraqitën nga përfaqësuesit e AKA-s, si dhe kërkoi transparencë dhe profesionalizëm në procesin e akreditimit të programeve.

Albulena Balaj- Halimaj, tha se sfidat të cilat u paraqiten nga përfaqësuesit e AKA-s, shihet se janë për shkak të numrit të vogël të personelit të Agjencisë dhe kërkoi që të ndërmerren masa për plotësimin e këtyre pozitave.

Ismajl Kurteshi, tha se mungesa e komisionit për shqyrtim të ankesave në kuadër të Agjencisë pamundëson realizimin e një të drejte të palëve. Ai kërkoi sqarim nga përfaqësuesit e AKA-s, se përveç çështjes së akreditimit, Agjencia a e përcjellë edhe punën në institucionet e arsimit të lartë, në lidhje me vlerësimin e cilësisë.

Në lidhje me shkresën e dërguar nga ushtruesja e detyrës së drejtorit ekzekutiv të AKA-s, Kurteshi tha se kjo çështje do të duhej të diskutohej edhe me ministrin.

3. Të ndryshme.

Për këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 14:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Ismajl Kurteshi